



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/262 Nr. i faq/Br.str/No.pg 71

Data/Datum/Data 29.10.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 shkronja h) dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011”), nenit 3 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 10/2023 për kriteret dhe procedurat e themelimit dhe pushimit të veprimtarisë së institucioneve të arsimit parauniversitar, Pëlqimit të MASHTI-it për themelimin e Institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë të komunës së Rahovecit, me Nr. Prot. 2/1809, të datës 4.10.2024, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, paragrafi 2, pika 2.11 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.8 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë **29.10.2024**, miraton këtë:

V E N D I M

Për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë të komunës së Rahovecit

- 1. Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot.4855, i datës 16.10.2024 dhe merret vendimi për themelimin e institucionit për edukim në fëmijërinë e hershme në Xërxë të komunës së Rahovecit.
- Institucioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka këto të dhëna:
 - 2.1.** Drejtoria për Arsim;
 - 2.2.** Komuna e Rahovecit – Xërxë;
 - 2.3.** Çerdhja për fëmijë në Xërxë;
 - 2.4.** Institucioni për edukim në fëmijërinë e hershme;
 - 2.5.** Kodi i institucionit edukativo-arsimor është: 250/4;
 - 2.1.** Niveli i veprimtarisë edukativo-arsimore është: 0.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Arsim,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.262/24
Datë: 29.10.2024

